Kronikë

# I vihet tritol makinës luksoze në Vlorë, menaxheri i kazinosë së kompleksit 'Marina bay': Nuk kam konflikt me njeri (VIDEO)

*Me 200 gram tritol ka shpërthyer makina luksoze e menaxherit të një kazinoje në Vlorë. Audi A6 në pronësi të Ermal Kasës. Ngjarja u shënua rreth orës 02:55 të së hënës në lagjen 'Pavarësia'.*







Redaksia
30 Maj, 07:18 | **Përditesimi i fundit: 30 Maj, 12:26**


Me 200 gram tritol ka shpërthyer makina luksoze e menaxherit të një kazinoje në Vlorë. Audi A6 në pronësi të Ermal Kasës. Ngjarja u shënua rreth orës 02:55 të së hënës në lagjen 'Pavarësia'.

Automjeti luksoz ishte i parkuar përpara pallatit ku banonte 31-vjecari, ndërsa nga shpërthimi i fuqishëm janë tronditur banorët e zonës. Policia tha se Ermal Kasa është nga Elbasani por jeton e punon prej disa muajsh në Vlorë. Kasa është menaxher i kazinosë pranë resorit të njohur "Marina bay" në zonën e Ujit të Ftohtë.




LEXO EDHE:
**Rama: Në tunelin e Llogarasë, 2 kilometra të hapur për 5 muaj! Do e përfundojmë para afatit**


Nga këqyrja e kamerave të sigurisë mësohet se eksplozivin në automjetin "Audi" A6 e kanë vendosur 2 persona të maskuar, të cilët ende nuk janë identifikua nga policia.

Automjeti luksoz ka vetëm dëme materiale, ndërsa në dëshminë paraprake Kasa ka thënë se nuk ka konflikte personale. Hetimet janë përqendruar tek hakmarrja për shkak të detyrës së 31-vjecarit Kasa, si menaxher në kazinonë e kompleksit luksoz "Marina bay".

Në përditësim...





Marina Bay vlore

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

**Ora 08:50**

## Vlorë/ Shpërthimi me tritol në makinën luksoze, eksplozivi u vendos nga dy persona të maskuar

Nga këqyrja e kamerave të sigurisë mësohet se eksplozivin në automjetin luksoz tip "Audi" e kanë vendosur 2 persona të maskuar. Makina është në pronësi të 31-vjeçarit Ermal Kasa, me origjinë nga Elbasani, por që prej pak kohësh jetonte në Vlorë pasi punon si menaxher në një kazinonë e kompleksit 'Marinabay'.

A.M./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Vlore, shperthim, tritol, ermal kasa, audi

Komento


© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



**Sondazhi i ditës:**
**Digjet edhe raundi i tretë, i kujt është faji që ka dështuar gjetja e një Presidenti konsensual?**

PS | OPOZITËS | NUK E DI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



## Lajme të tjera

Kronikë

Aksident në Vlorë/ Autoboti del nga rruga, plagoset shoferi
29 Maj, 12:20

Sociale

Një leje ndërtimi e vitit 2009-të për ndryshimin e strukturës së një pallati, në lagjen 24 Maji në Vlorë ka rezultuar fatale për 40 familje
27 Maj, 14:34

Kronikë

Gjendet turisti francez që humbi rrugën në Llogara, ishte nisur drejt malit të Karaburunit për të zbritur në gjiret e gadishullit
27 Maj, 07:10

Kronikë

Zhvillohet në Vlorë stërvitja ushtarake 'GRUPEX', anijet luftarake rrethojnë Karaburunin! Sot do kryhen qitje bregdetare me top e mitralozë
26 Maj, 11:04

Kronikë

Shkrumbohet autobusi në Vlorë, po transportonte punonjësit e fasonerisë! Asnjë i lënduar
26 Maj, 07:12

Kronikë

Aksident në Vlorë, përplasje e fortë mes dy makinave
24 Maj, 23:50

Kronikë

U arrestua se dha certifikata pronësie për tokat në bregdet, lirohet ish-drejtori i Kadastrës Sarandë
24 Maj, 17:48

Opinion

Frrok Çupi: Diva – Divine – Divjakë
Frrok Çupi
24 Maj, 16:26

Kronikë

Shkrumbohet plotësisht një makinë në Vlorë, dyshohet për zjarrvënie të qëllimshme
24 Maj, 16:08

Sport

Armand Duka përballet në Gjykatë me Shakohoxhën, merr avokati mbrojtësin e personit që akuzohet se i vendosi tritolin në shtëpi! Gjyqtar i çështjes Agron Zhukri
24 Maj, 14:29

Kronikë

Ishte kthyer ne makthin e banorëve, arrestohet 'hajduti serial' në Vlorë
24 Maj, 11:28

Kronikë

Shpërthim gazi në një pikë shitje në Shkozet të Durrësit, lëndohen dy punonjës
23 Maj, 11:33





© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje